

LIGJ
Nr.7721, datë 15.6.1993

PËR NDARJEN E VEPRIMTARISË SË MINISTRISË TË PUNËS, EMIGRACIONIT,
PËRKRAHJES SOCIALE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë i shkëputet veprimtaria për ish të përndjekurit politikë dhe emërtimi i saj bëhet: Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

Neni 2

Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale e zhvillon veprimtarinë e saj në fushën e marrëdhënieve të punës, emigracionit dhe mbrojtjes shoqërore.

Neni 3

Në Këshillin e Ministrave krijohet Komiteti i ish të Përndjekurve Politikë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.564, datë 19.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.